



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 2
Prishtinë, më 30.12.2014, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS

Në mbledhje morën pjesë: Daut Haradinaj- kryetar, Fadil Demaku- zëvendëskryetar i parë, Anton Quni, Nuredin Ibishi, Zafir Berisha dhe Qerim Bajrami-anëtarë.

Mungoi:Bojan Mitiq dhe Ganimete Musliu.

Pjesmarrësit nga Ministria e FSK-së: Haki Demolli, ministër, Gjenerallejtënant Kadri Kastrati, asistent ushtarak, Fadil Hoxha.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Luanda Domi-DCAF .

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku dhe Zarife Aliu.

Mbledhjen e kryesoi: Daut Haradinaj, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjes së Komisionit të mbajtur më 23.12.2014;
3. Takim njoftues me Komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, Gjenerallejtënant Kadri Kastrati;
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryetari- Propozoi ndryshimin e rendit të ditës, në mënyrë që pas pikës së parë të fillohet me pikën e tretë të rendit të ditës.

Rendi i ditës u miratua me ndryshime.

2. Takim njoftues me Komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, Gjenerallejtënant Kadri Kastrati.

Kryetari- Prezent sot kemi ministrin e FSK-së, Komandantin e FSK-së dhe asistentin e tij. Duke qenë se ky vit është i rëndësishëm për FSK-në, si Komision e kemi obligim legjislativ dhe me mbështetjen tuaj do të ushtrojmë funksionin mbikëqyrës ndaj obligimeve që dalin ligjërisht. Ju përgëzoj për arritjet e deritanishme dhe ju urojmë punë të mbarë. Arsye e këtij takimi është formal dhe ne, si Komision, do të ofrojmë mbështetjen serioze për FSK-në. Fjalën ua dha përfaqësuesve të ministrisë së FSK-së.

Ministri i Ministrisë së FSK-së, Haki Demolli- Falënderoi për ftesën në Komision dhe vlerësoi se si ministri ndjehen me fat që është kjo përbërje e këtij Komisioni, të cilët janë njohës të fushës. Gjithashtu vlerësoi se është pozitive që kemi kontrollin demokratik dhe mbikëqyrjen demokratike, dhe përmes këtij kontrolli të realizohet një punë e qëndrueshme dhe të suksesshme. Për këtë vit, është e pritshme që do të kemi suksese pasi përpara vetes kemi transformimin e FSK-së në Forca të Armatosura. Si ministri jemi të hapur që vërejtjet dhe sugjerimet që vijnë nga ana e Komisionit, t'i përmirësojmë në mënyrë që Kosova të ketë një forcë të armatosur me kapacitete të mira. Dhe ju uroj punë të mbarë si Komision, ne si ministri do të jemi të hapur ndaj çdo vërejtje dhe tokemi qëndrueshmëri në punën tonë.

Gjenerallejtënant Kadri Kastrati- Vlerësoi se FSK-ja ka përmbyllur një vit shumë të suksesshëm, pasi objektivat dhe prioritetet e përcaktuara janë realizuar dhe janë më të zhvilluara dhe avancuar se një vit më parë. Ju falënderoj për përkrahjen e vazhdueshme si Komision. Ju informoj që ne kemi bërë planet zhvillimore afatgjate dhe jemi të gatshëm të ua prezantojmë në të ardhmen e afërt.

Çdo herë kemi qenë të hapur dhe transparent dhe do të jemi për të ju informuar për zhvillimet e forcës dhe do të raportojmë në afate kohore sipas rregulloreve.

Fadil Demaku- Ne, si Komision, i kemi mundësitë që të kemi bashkëpunim të mirë me Ministrinë e FSK-së. Anëtarët e Komisionit, përveç anës profesionale, kanë edhe dëshirën që FSK-ja të jetë atje ku duhet.

Sa i përket mbikëqyrjes parlamentare në kuadër të Ministrisë së FSK-së, do të kemi bashkëpunim dhe do të kontribuojmë në bazë të ligjit që na obligon.

Anton Quni- Nga përvoja e Komisionit të legjislaturës së kaluar, autoritete e FSK-së janë shumë të mira. Jam i bindur që do të kemi bashkëpunim shumë të mirë. Gjithashtu do të kërkojmë nga Gjenerali i FSK-së, që në fazën e parë të transformimit të FSK-së në FAK, si është paraparë? Pasi gjatë debatit për buxhetin është theksuar që nuk është përfshirë kjo.

Gjenerallejtënant Kadri Kastrati- Plani afatgjatë zhvillimor për vitin 2015-2025, i ka paraparë të gjitha zhvillimet, pajisjet, infrastrukturën etj. Kjo është data baza që është dorëzuar në janar të vitit 2014 dhe të gjitha rekomandimet që kanë dalë nga rishikimi Strategjik i Sektorit të Sigurisë, kanë qenë të fokusuar që Qeveria e Kosovës duhet që çdo vit deri në vitin 2019, të ndajë nga 5 milionë shtesë për formimin e forcave të armatosura.

Qeveria në atë kohe e ka dhënë pëlqimin, por kjo çështje nuk ka kaluar në Kuvend dhe është kthyer mbrapa.

Për këtë vit nuk janë paraparë pjesa e atyre mjeteve financiare, por kur është mbrojtur buxheti para drejtorit për Buxhet pranë ministrisë së FSK-së, është thënë që Qeveria e ka buxhetin dhe po sa të kalojnë ndryshimet kushtetuese në Kuvend. Qeveria do të ndajë mjetet e nevojshme për transformimin FSK-së në FAK.

Ministri i FSK-ë, Haki Demolli- Lidhur me çështjen e ngritur nga z. Quni, si ministër jam interesuar për buxhetin e kësaj ministrie para se ligji për buxhetin të procedohet në Kuvend, dhe më është thënë që vlerësimi i brendshëm ka qenë se mjaftojnë këto 45 milionë që janë në dispozicion, ndërkohë nëse aprovohet ligji për transformimin e FSK-së, atëherë do të aprovohet kostoja për këtë ligj që duhet të jetë 5 milionë gjatë shqyrtimit të buxhetit në muajin qershor.

Kryetari- Shumica e deputetëve kanë mbështetur buxhetin për FSK-në dhe ne, si Komision, presim strategjinë për vitet në vijim në mënyrë që të japim mbështetje, edhe pse jemi të pa kënaqur për trajtimin buxhetor të FSK-së, pasi ka pasur ridestnim të mjeteve dhe kjo është gabim.

Zafir Berisha- Si anëtarë të Komisionit, jemi të afërt dhe sa i përket transformimit të FSK-së do të ketë pengesa. Nuk besoj që vijat buxhetore do të jenë pengesë, sa do të jetë politika. Për këtë arsye dua të dijë, pasi ndryshimi i FSK-së nuk bëhet vetëm me ndryshimin e emrit, por me ngritjen e kapaciteteve, pasi edhe ligji aktual nuk i kufizon disa gjëra. Pasi transformimi thelbësor është i rëndësishëm.

Konsideroi se si Komision do të kalojmë mirë, pasi kemi përpara vetës një segment të rëndësishëm që i tejkalon kufijtë partiak dhe politik.

Nuredin Ibishi- Theksi se duhet të jemi pak kritikë në aspektin e asaj se duhet shikuar mundësia që përveç rolit të mbrojtjes kolektive të merret parasysh edhe sistemi i bilancit rajonal të forcës. Ky aspekt duhet të merret parasysh, pasi Kosova është pak larg nga ky aspekt në proporcion me numrin e banorëve. Ju dëshiroj sukses në punë tuaj.

Qerim Bajrami- Falënderoi kryetarin për organizimin e këtij takimi. Pa marrë parasysh që sot nuk kemi një temë për të cilën do të flasim, ministrin e uroj për detyrën e re. Siç e dini unë vijë nga grupi parlamentar 6+, përfaqësoj komunitetin boshnjak, por në këtë grup ka edhe nga komuniteti turk, rom dhe ashkali. Deri tani ne jemi quajtur si komunitet konstruktiv.

Personalisht besoj që edhe FSK-ja e tanishme edhe ajo e të ardhmes nuk do të kenë mendim tjetër për komunitetet jo shumicë. Përveç kësaj të gjithë këto procese do të jenë edhe procese tonat dhe në to të marrim pjesë në mënyrë konstruktive dhe të japim kontributin tonë. Vlerësoj që edhe në të ardhmen konstruktiviteti ynë do të ketë kufij dhe ajo ka të bëjë me pjesëmarrjen tonë në të gjitha këto procese.

Është një pyetje që e kam bërë vazhdimisht edhe kur kam qenë zëvendësministër i diasporës, se sa janë të përfaqësuar komuniteti boshnjak në ministri, ushtri dhe polici? Dhe përgjigjja për këtë asnjëherë nuk ka qenë e saktë dhe për informimin tuaj fatkeqësisht në gjithë nivelin qendror ka maksimumi 20 boshnjakë. Prandaj mendojmë që duhet të rregullojmë gjendjen tonë.

Gjenerallejtënant Kadri Kastrati- Lidhur me atë që theksoi z. Ibishi, ne, si FSK, jemi të gatshëm që nga sot të bëjmë prezantimin e strukturës dhe kapaciteteve që forca e ardhshme duhet të ngritën ndër vite.

Nuk do të krijojmë një forcë që do të ketë kapacitete mbrojtëse, pro të gjitha pajisjet, armatimin dhe strukturën, ne jemi të gatshëm të prezantojmë.

Ndërsa sa i përket komunitetit boshnjak, në FSK kemi 2.02%(45 ushtarë) dhe dy kadet që shkollohen në Maqedoni në Akademinë e Mbrojtjes.

Ndërsa sa i përket komunitetit jo shqiptar në FSK, FSK-ja me plotë kuptimin e fjalës mund të thuhet që është forcë multietnike.

Kryetari- Kur do të jetë në komision projektligji për transformimin FSK—së nga ana juaj z. Qerimi, mund të bëhen propozime dhe amendamente të cilat më pas të bëhen pjesë e ligjit. FSK-ja, i ka paraprirë një procesi që të ketë bashkëpunim me komunitetet jo shumicë në Kosovë. Prandaj në emër të Komisionit falënderoj për këtë takim formal përfaqësuesit e Ministrisë së FSK-së me bindjen që në vitet në vijim do të sillet plani dinamik i transformimit.

Ndryshimet kushtetuese do të kërkojnë mbështetjen e dy të tretave të shumicës, por shpresojmë që të gjithë deputetët do të jenë përkrahës të këtij procesi.

Gjithashtu kemi disa vërejtje për mënyrë se si janë menaxhuar disa çështje në kuadër të ministrisë së FSK-së, sidomos për pronësimin e disa kazermave, investimet ku nuk ka titullar, menaxhimi i buxhetit etj.

Si Komision do të mbikëqyrim buxhetin për ndërtimin e kazermave dhe do të vizitojmë edhe fizikisht. Nëse nuk keni çështje për të diskutuar, lirojmë përfaqësuesit e ministrisë së FSK-së dhe vazhdojmë me rendin e ditës.

3. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjes së Komisionit të mbajtur më 23.12.2014;

Kryetari, konstatoi miratimin e procesverbalit të mbledhjes të Komisionit të mbajtura më 30.12.2014

Procesverbalet u miratuan pa vërejtje.

4. Të ndryshme.

Kryetari i njoftoi anëtarët e Komisionit për takimin që ka pasur me përfaqësuesit e disa organizatave, siç është KDI. Gjithashtu theksoi se është interes në të mirë të Komisionit që të kemi kontakte edhe me organizata të tjera.

Gjithashtu nga ana juaj do të kërkoj mbështetje nëse është e nevojshme që të kemi bashkëpunim me këto organizata, pasi janë disa nga organizatat që janë të gatshme të ofrojnë mbështetje dhe ekspertizë. Qëllimi është të krijojmë bashkëpunimin me GIZ, GAP, KDI dhe DCAF. Për mbështetjen e DCAF jam në njohuri dhe ka qenë mbështetje e jashtëzakonshme për komisionin.

Gjithashtu dua të theksoj rastin e fundit që ka ndodhur kur është arrestuar një serb në Prishtinë. Lidhur me këtë çështje kam kontaktuar me ministrin e Punëve të Brendshme dhe drejtorin e Përgjithshëm të Policisë, dhe me është thënë se është rast i izoluar dhe se ju takon organeve të rendit të bëjnë punën e vet.

Nuredin Ibishi- Vlerësoi se kontaktet me organizatat e ndryshme janë të mirëpritura, janë CDF dhe UNDP të cilat do të mund të kontribuonin në punën e Komisionit. Do të ishte pozitive nëse do të ofroje mbështetje me ndonjë jurist profesional.

Ndërsa sa i përket rastit të arrestimit të një qytetari serb në Prishtinë tha se, edhe pse llogaritet si rast i izoluar, bazuar në Ligjin e Policisë, nenit 22, që i referohet kontrollit parandalues, ka pas raste që nuk është reaguar si duhet.

Pasi bazuar në këtë nen, policia ka të drejtën e ndalesës, bastisje pa lejen e prokurorit ose gjyqtarit, por më pas i raporton prokurorit publik, i cili më pas e arsyeton ndërmarrjen e veprimit.

Kryetari- Në aspektin formal theksoi se duhet të jemi të kujdesshëm, pasi për këtë rast kam biseduar me ministrin dhe drejtorin e Përgjithshëm të Policisë dhe janë të gatshëm të raportojnë për këtë çështje.

Në takimet e radhës kurdo që do të jenë në raportim mund të kërkojmë informacion për këtë çështje dhe të mbikëqyrim implementimin ligjeve. Për rastin konkret duhet t'i përgëzojmë, pasi kanë shënuar arritje duke mos lejuar të ketë pasoja fatale.

Gjithashtu si Komision duhet të ushtrojmë mbikëqyrje në shpenzimet buxhetore nga ana e FSK-së, pasi disa raporte tregojnë që ka pasur keq menaxhim, ku është investuar në kazerma pa titullar, ose ndarja e buxhetit për poliklinika pa planifikim.

Pajtohem që kapacitete e FSK-së në të ardhmen të jenë të balancuar me ato të rajonit dhe ne, si Komision, do të luajmë rolin tonë mbështetës.

Fadil Demaku- Theksoi se çështjet që u diskutuan janë në kuadër të punës dhe angazhimit të Komisionit. Gjithashtu shtoi se mirë do të ishte të mos paragjykohej paraprakisht, por të vazhdojmë me kontinuitetin me çështjet për të cilat mund të kemi dyshime si Komision. Nga përvoja me Komisionin për AKI në legjislaturën e kaluar, përvoja me organizatat ka qenë shumë e dobishme, duke ofruar praktikë më të mira për mbikëqyrjen demokratike të sektorit të sigurisë, por duhet të kemi parasysh që vota shumicë e Komisionit përcakton prioritetet dhe punët e Komisionit.

Qerim Bajrami- Propozoj që të kemi kontakte edhe me ambasadat, të cilët mund të krijojnë kontakte me vendet prej nga vijnë në mënyrë që të kemi bashkëpunime me to.

Kryetari- Kjo do të parashikohet në mënyrë që të kemi bashkëpunim. Nëse nuk keni çështje për të diskutuar e konsiderojmë të mbyllur takimin.

Mbledhja përfundoi në orën 11:45.

Përgatitur nga:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Daut Haradinaj